



Strehëza për gra
dhe vajza të
abuzuara

Rrjeti për Zbatimin e Dënimeve Alternative

Buletin 7, Tetor 2011.

**AKTIVITETE TE REALIZUARA NE KUADER TE
PROJEKTIT ZBATIMI I DENIMEVE ALTERNATIVE**

www.NCSO-AL.org

Publikimi i Studimit Efektiviteti i Zbatimit të Dënimeve Alternative në Shqipëri

Në kuadër të projektit Rrjeti Kombëtar për Zbatimin e Dënimeve Alternative u realizua botimi I një studimi vlerësues. Studimi I titulluar Efektiviteti I Zbatimit të Dënimeve Alternative u hartua për një periudhë kohore disa mujore nga stafi I projektit si dhe nga ekspertë të kontraktuar për këtë qëllim. Ky studim ofron informacion ne lidhje me funksionimin e institucionit të Shërbimit të Provës në Shqipëri në lidhje me mbikëqyrjen e subjekteve me Dënim Alternativ.

Në kuadër te vlerësimit të punës së kryer nga Shërbimi I Provës është mundësuar një vlerësim I praktikave të ndjekura, strategjive të zbatuara, problematikave që ky institucion adreson dhe sfidave që ndesh në komunitet.

(Vijon në faqen 3)



Në këtë numër:

1. Publikimi i Studimit Efektiviteti i Zbatimit të Dënimeve Alternative në Shqipëri
2. Zbatimi i programeve multi-disiplinare dhe subjektet perfituese
3. Instrumentet Vlerësuese mbi Recidivizmin
4. Qendra e Re Aksion +
5. Hapja e Zyrave të Reja Vendore të Shërbimit të Provës



This publication has been produced with the financial assistance of the European Union.

This publication has been produced in the framework of: Network for the Implementation of Alternative Sentence project.

Zbatimi i programeve multi-disiplinare dhe subjektet perfituese

Projekti Rrjeti Kombëtar për Shërbimet e të Pandehurve në komunitet, në punën e tij që prej Janarit 2010 ka mundësuar zbatimin e programeve të tij multidisiplinare në qytetet dhe zyrat vendore të Tiranës, Durrësit, Fierit, Shkodrës dhe Korcës. Gjatë kësaj periudhe subjektet me Dënim Alternativ kanë përfitur në programe të tilla si:

Shërbimi i konsulencës, nga ky program kanë përfitur dhe kanë marrë pjesë aktivisht 95 persona referuar nevojave të tyre specifike të varësisë nga droga të cilët ndjekin terapinë mbajtëse ambulatore me Metadon si dhe seancat e këshillimit individuale dhe familjare. Duhet theksuar se gjatë zhvillimit të këtyre seancave përveç personave që janë në Shërbimi Prove kanë përfitur dhe familjarët e tyre të cilët janë informuar rreth këshillimit në lidhje me varësinë ndaj substancave narkotike, efektet përkatëse, stabilizimi i një komunikimi pozitiv mes klientëve dhe antërave të familjes dhe si ndikon kjo marrëdhënie në riintegrimin e tij në shoqëri.

Gjatë zbatimit të programit të menaxhimit të zemerimit janë trajtuar dhe kanë marrë pjesë 75 persona. Këto subjekte janë seleksionuar nga stafi i Shërbimit të Provës në bashkëpunim me specialistët me e organizatës. Si fillim u hartua manuali mbi etapat e programit të menaxhimit të zemerimit, iu prezantua specialistëve të Shërbimit të Provës dhe të ligjit gjatë trajnimeve të zhvilluara dhe pastaj nisi



zbatimi i tij me subjektet e përzgjedhura dhe nevojave specifike që paraqisnin. Në seancën e parë të zhvilluar u ftuan të gjithë subjektet të cilëve iu prezantua programi me objektivat dhe 12 etapat përkatëse. Ky program realizohet dhe mbështetet nga psikologë të qëndrës të cilët punojnë për rrjetin e zbatimit të Dënimeve Alternative. Në fillim të programit, të dënuarit me Shërbim Prove manifestuan episode të zemerimit të cilat filluan të reduktoheshin me zbatimin e programit. Programi i menaxhimit të zemerimit duke përfshirë komponentë të tillë si qëndrueshmëria emocionale, aftësitë, komunikimi dhe ndërveprimi social ndikon pozitivisht në riintegrimin e këtyre personave në komunitet. Së fundi, vijueshmëria e programit është positive gjatë kësaj faze llogaritet që 75 subjekte e kanë përfunduar më sukses dhe 13-të të tjerë janë ende duke e ndjekur seancat e tij.

Në kurset profesionale si parukeri, elektrikist, mekanik kanë marrë pjesë dhe kanë përfitur 45 persona të cilët janë pajisur me diplomat përkatëse si pjesë e marrëveshjes së Memorandumit të Bashkëpunimit midis Rrjetit Kombëtar dhe Shërbimit të Provës, diplomë e cila është e miratuar nga Ministria e Punës dhe e Cështjeve Sociale.

Një rol vendimtar në realizimin me efektivitet të projektit kanë patur trajnimet informuese, edukuese dhe ndërgjegjësuere. Gjatë këtyre trajnimeve informuese në lidhje me supervizimin e Dënimeve Alternative në komunitet kanë marrë pjesë 45 prokurorë dhe gjyqtarë. Gjatë zhvillimit të këtyre trajnimeve u prezantuan programet e shërbimeve të ofruara nga Rrjeti Kombëtar me qëllim që përfaqësuesit e ligjit të njohin dhe vlerësojnë konkretisht procesin e mbikëqyrjes nga shoqatat partnere të rrjetit.

Instrumentet Vlerësuese mbi Recidivizmin

Parashikimi dhe zbatimi i Dënimeve Alternative në nenet 58-64 të Kodit tonë Penal, krijimi i institucionit të Shërbimit të Provës prej Majit të vitit 2009, pajisjes me kompetencat e nevojshme në mbikëqyrjen e Dënimeve Alternative në komunitet, konsolidimit të statusit të punonjësve të Shërbimit të Provës parashtron edhe problematikën e mungesës së politikave apo instrumenteve të besueshëm dhe të vlefshëm për të mbledhur informacion rreth rrezikshmërisë së të dënuarit, riskut të recidivizmit dhe vlerësimit të nevojave të tij në sajë të procesit efektiv të kontrollit dhe monitorimit të Shërbimit të Provës dhe shërbimeve komunitare. Kyci i suksesit për cdo program efektiv të menaxhimit të rrezikshmërisë shoqërore është marrja e vendimeve pas vlerësimit të të gjithë informacionit të mundshëm.

Në praktikë, analiza e rrezikshmërisë së të dënuarit për të kryer vepër tjetër penale shërben për të strukturuar shumë nga vendimet që merren në kuadër të përmbushjes së detyrimeve të caktuara nga gjykata dhe të përcaktimit të programeve për tu ndjekur nga nga i dënuari.

Kapaciteti për të zhvilluar dhe ndërmarrë vlerësime të rrezikshmërisë shoqërore të të akuzuarit është drejtpërdrejt i lidhur me sasinë e informacionit që organi i ekzekutimit ka në dispozicion të tij.

Shumica e instrumentave që përdoren sot në vendet evropiane janë krijuar në fund të viteve 70-të dhe në fillim të viteve 80-të të shekullit të 20-të. Ndër instrumentat më të rëndësishme mund të përmendim si psh: Rezultati i Faktorit, Sistemi i Klasifikimit për menaxhimin e klientit, Nivelit i mbikëqyrjes, Informacioni Statistikor për Shkallën e Recidivizmit. Këto instrumenta përdorin teknika matëse objektive edhe pse realiteti ka cuar në përfundimin se vlerësimi është një process integrative që përfshin shumë metodologji vlerësimi.

Studimet mbi vlerën parashikuese të vlerësimit të rrezikshmërisë shoqërore dhe nevojave të të dënuarve

kanë treguar që faktori i historisë penale është shumë i lidhur me rezultatet e mbikëqyrjes në komunitet. Vlerësimi i kombinuar i rrezikshmërisë dhe i nevojave e përmirëson shumë mundësinë e parashikimit nëse i dënuari do të kryejë një vepër tjetër penale apo jo.

Për të patur një vlerësim të nevojave të të dënuarit, të rrezikshmërisë shoqërore dhe të faktorëve të tjerë që mund të ndikojnë në mënyrë positive në riintegrimin në shoqëri të të dënuarit u zhvillua " Shkalla e Menaxhimit të Rrezikshmërisë dhe e Nevojave të të Dënuarit në Komunitete nga Shërbimi i Korrektimit në Kanada për të mbledhur informacion për raste të vecanta mbi historinë penale si dhe u zhvillua një sistem për klasifikimin e të dënuarve sipas nevojave të të dënuarve.

Shkalla e Menaxhimit të Rrezikshmërisë dhe Nevojave të të Dënuarit në Komunitet fokusohet në procesin e mbikëqyrjes dhe monitorimit e ndryshimeve në sjelljen e të dënuarit, qëndrimet dhe kontekstin social ku është i vendosur ai gjatë kohës në mbikëqyrje.

Fushat e përzgjedhura për nevojat e rastit të Shkallës së Menaxhimit të Rrezikshmërisë dhe e Nevojave të të Dënuarit në komunitet janë ato që përfshihen në instrumentat e vlerësimit të nevojave. Në këtë shkallë vlerësohen si si nevoja 12 fusha, të tilla si: niveli arsimor dhe profesional, punësimi, menaxhimi financiar, marrëdhëniet martesore/familjare, kushtet e jetesës, stabiliteti emocional dhe i sjelljes, përdorimi i drogës, aftësitë mendore, shëndeti dhe qëndrimi ndaj ligjit.

Vlerësimi i këtyre nevojave, menaxhimi i recidivizmit, parandalimi i sjelljes shoqërisht të rrezikshme duke vlerësuar faktorët dinamikë, aktivizimin e komunitetit, funksionimi i institucioneve të drejtësisë ndikojnë pozitivisht në parandalimin dhe reduktimin e sjelljes kriminale.



Publikimi i Studimit Efektiviteti i Zbatimit të Dënimeve Alternative në Shqipëri

(Vijon nga faqja 1)

Ky studim është bazuar në një metodologji kërkimore e cila mbështetet në përdorimin e metodave sasiore dhe cilësore. Qëllimi i kombinimit të të dy metodave lidhet ngushtë me objektivat specifike të studimit. Ndër çështjet me rëndësi të trajtuara në studim mund të përmendim: Prezantimin e një kronologjie historike analitike të krijimit dhe zhvillimit të Shërbimit të Provës në Shqipëri dhe në botë.

Paraqitja e kuadrit ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar në të cilin bazohet kompetenca e Shërbimit të Provës.

Analizimi i punës së deritanishme duke iu referuar rasteve konkrete dhe programeve rehabilituese dhe ri-integruese të ofruara për këtë qëllim.

Së fundi, prezantimi i disa politikave që përdoren gjërisht në vende si Anglia, Holanda, Danimarka, Franca, Italia në rritjen e efektivitetit të mbikëqyrjes së Dënimeve Alternative në komunitet, për minimizimin e recidivizmit të të dënuarit, konsolidimin e statusit të punonjësve të Shërbimit të Provës si dhe krijimin e mekanizmave komunitare dhe institucionalë si mundësi për arsim, punësim dhe strehim.



Qendra e Re



Shoqata Aksion +, së fundi ka inagruar qendrën e saj të re. Aksion + operon në dimensione si edukimi bashkëmoshatar, trajtimi mbajtës me metadon, terapi këshillimi individuale dhe familiar, kurse profesionale, advokasi me struktura qeveritare, agjensi të huaja, donatarë dhe rrjete rajonale ndërkombëtare si CEEHRN, SWAN, IHRD, SEEA, si dhe ndërtim kapacitetesh, nëpërmjet trajnimeve të ndryshme në Universitete, shkolla të mesme dhe në 9 vjecare. Numri i subjekteve të trajtuara që prej vitit 2005, në qytetet kryesore të Shqipërisë është 645. Gjithashtu, Aksion +, në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit me Shërbimin e Provës ofron për subjektet me Dënim Alternativ, referim rastesh, trajtim psikosocial, këshillim profesional dhe kurse profesionale.



Hapja e Zyrave të Reja Vendore të Shërbimit të Provës

Institucioni i Shërbimit të Provës në kuadër të objektivave të tij ka mundësuar shtrirjen e tij edhe në qytete si Korca, Lezha, Elbasan, Gjirokastër. Në muajin tetor, përfaqësuese të Rrjetit Kombëtar për Zbatimin e Dënimeve Alternative në komunitet ka realizuar takime me përfaqësues të zyrave të reja vendore. Qëllimi i këtyre takimeve ishte prezantimi me inspektorët e Shërbimit të Provës, diskutimi i procedurën së punës, referimi i rasteve, delegimi i çështjeve, rritja e bashkëpunimit dhe konsolidimi i rrjetit.

